

Prot. nr. 308
dt 14.2.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



MANUAL UDHËZUES

Për Certifikimin dhe ricertifikimin e punonjësve të sigurisë

Shkurt 2019

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.





Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

Drejtor Ekzekutiv

LISTA E FAQEVE EKZISTUESE

Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë		Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë

	Emri dhe pozicioni	Datë	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Aurela Doku	06.02.2019	
Rishikuar:	Erjon Tema	07.02.2019	
Kontrolluar nga:	Selma Pagria	11.2.2019	
Miratuar nga:	Krislen Keri	14.2.2019	

LISTA E SHPËRNDARJES

Përdoruesi	Media/Mediumi	Sasia
Arkivi	Në Letër	1
	Elektronike	1
Intranet	Elektronike	1

REGJISTËR I RISHIKIMEVE

Nr:	Data:	Rishikuar nga:	Miratuar nga:
1			
2			
3			
4			

1. PËRKUFIZIME

Për qëllimin e kësaj procedure, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

- a) Punonjës i Sigurisë: Do të thotë ç'do person që kryen detyrat e sigurisë në fushën e aviacionit civil në njërin nga subjektet e përmendura në pikën 1 të kësaj procedure, duke përfshirë supervizorët dhe menaxherët e sigurisë të të gjitha niveleve.
- b) Skanerues Sigurie: Do të thotë ç'do person që gëzon të drejtën të operoj në pajisjet me rreze X ose EDS siç përcaktohet në Certifikatën e lëshuar nga AAC.
- c) Patrullues Sigurie: Do të thotë ç'do person që gëzon të drejtën për të patrulluar nëpër ambientet e aeroportit, Albcontrol apo të kompanive ajrore siç përcaktohet në Certifikatën e lëshuar nga AAC.
- d) Ruajtës Fizik: Do të thotë ç'do person që gëzon të drejtën të mos lejoj aksesin e personave të cilët nuk janë të autorizuar të kalojnë në një pikë kalimi ku ata janë të ngarkuar të kryejnë shërbimin siç përcaktohet në Certifikatën e lëshuar nga AAC.
- e) Kandidat për Personel Sigurie: Do të thotë personi i cili është duke marrë trajnimin bazik për punonjës sigurie i cili do t'i nënshtrohet çertifikimit fillestar.

2. SHKURTIME

Në këtë procedurë do të përdoren shkurtime të mëposhtme, të cilat do të nënkuptojnë:

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
DSA	Drejtoria e Sigurisë në Aviacion
DE	Drejtor Ekzekutiv
EDS	Sistemi i Zbulimit të Eksplozivëve
OJT	Trajnimi në punë (on job training)
PKSAC	Programi Kombëtar i Sigurisë në Aviacionin Civil
PKTSAC	Programi Kombëtar i Trajnimeve të Sigurisë në Aviacionin Civil.
SCMPSA	Sektori i Certifikimit & Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë në Aviacion

Tabela e Përmbajtjes

1.	PËRKUFIZIME.....	5
2.	SHKURTËME	5
3.	BAZA LIGJORE.....	7
4.	QËLLIMI:.....	7
5.	FUSHA E ZBATIMIT:	7
6.	POLITIKAT DHE PROCEDURAT:.....	7
7.	KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM PUNONJËS SIGURIE	9
8.	KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM – OPERATOR SKANERI.....	9
9.	KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM – DREJTUES SIGURIE	10
10.	KËRKESAT PËR RI-ÇERTIFIKIM	11
11.	TRAJNIMI	11
13.	VLERËSIMI	11
14.	SHTOJCA A.....	14

3. BAZA LIGJORE

Kjo procedurë është hartuar në përputhje me VKM Nr. 575, datë 10.08.2011 për “Miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil”, pika 7.0 Çertifikimi i Sigurisë, Urdhërin e Përbashkët Nr. 4103, datë 19.09.2011 për “Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil”, Kapitulli 4 dhe në përputhje me Urdhërin Nr. 22, datë 06.03.2013 për “Miratimin e rregullores mbi masat e detajuara për zbatimin e standardeve të përgjithshme bazë në sigurinë e Aviacionit Civil”.

4. QËLLIMI:

Kjo procedurë vendos kriteret për certifikimin dhe ricertifikimin e punonjësve të sigurisë të cilët operojnë në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil Shqiptar. Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë si dhe Programi Kombëtar i Trajnimeve e ngarkon AAC-në, që të garantojë se i gjithë personeli i punësuar i sigurisë kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer me efikasitet dhe vigjilencë të gjitha funksionet e ngarkuara në përputhje me detyrat si personel sigurie (në aeroport, Albcontrol, kompanitë ajrore ose në agjentët e rregulluar).

5. FUSHA E ZBATIMIT:

Objekt i kësaj procedure janë të gjitha subjektet që janë të përfshira në punësim, trajnim dhe certifikim të personelit të sigurisë. Kjo procedurë aplikohet edhe në rastet e ricertifikimit vjetor të personelit të sigurisë.

6. POLITIKAT DHE PROCEDURAT:

- a) Punonjësit aktual – i gjithë personeli i sigurisë duhet të jetë i certifikuar sipas hierarkisë që mban dhe ç’do punonjës i cili dështon kryerjen me sukses të trajnimeve përkatëse nuk duhet lejuar të ushtrojë detyrat e tij/saj si punonjës sigurie. Punonjësi që ka dështuar për herë të parë në kryerjen me sukses të trajnimit duhet t’i jepet mundësia për ri-trajnim. Nëse punonjësi dështon për herë të dytë në kryerjen me sukses të trajnimit duhet t’i hiqet e drejta për të operuar si punonjës sigurie. Kjo procedurë aplikohet në të gjitha rastet.

- b) Punonjësit e testuar gjatë punës – i gjithë personeli që ka dështuar në testin gjatë punës ose i njohur ndryshe si ‘drill’ duhet të ri-testohet brenda një intervali shumë të shkurtër që nuk kalon 24 orë nga testimi fillestar. Nëse punonjësi i sigurisë dështon përsëri në identifikimin ose kalimin me sukses të testit duhet menjëherë të largohet nga operimi dhe t’i nënshtrohet trajnimit të rifreskimit. Nëse ndodhë që i njëjti person ka të njëjtat dështime në të ardhmen, atëherë duhet të merren masa për largimin e tij/saj nga puna.
- c) Punonjësit e larguar më shumë se 6 muaj nga operimi – ç’do punonjës i cili nuk ka ushtruar kompetencat e punonjësit të sigurisë për më shumë se 6 muaj nuk mund të kthehet në detyrë pa i’u nënshtrohet trajnimeve përkatëse siç përcaktohet në Urdhrin Nr. 22, datë 06.03.2013 “Masat e detajuara për zbatimin e standarteve të përgjithshme bazë në sigurinë e aviacionit civil”.
- d) Punonjësit e ri-punësuar – personeli i sigurisë i ri-punësuar duhet t’i nënshtrohet dhe të kryej me sukses trajnimin bazik për pozicionin përkatës si dhe t’i nënshtrohet procesit të certifikimit fillestar.
- e) Periudha e vlefshmërisë së Çertifikatës – Për Operatorët e Skanerit periudha e vlefshmërisë së certifikatës është 3 vjet me të drejtë ri-çertifikimi një herë në 12 muaj. Për të gjithë punonjësit e tjerë të sigurisë, periudha e vlefshmërisë së certifikatës është 5 vjet me të drejtë ri-çertifikimi një herë në 12 muaj.
- f) Ri-çertifikimi i punonjësve të sigurisë – ri-çertifikimi i punonjësve të sigurisë duhet të kryhet një herë në 12 muaj siç parashikohet në Urdhërin e Përbashkët Nr. 4103, datë 19.09.2011 për “Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil”.
- g) Aplikimi për ri-çertifikim – subjekti i përfshirë në punësimin e personelit të sigurisë duhet të aplikojë për ri-çertifikim të punonjësve të sigurisë 1 muaj para se t’i mbaroj afati i përcaktuar në certifikatën e aplikantit. Nëse nuk arrihet ri-çertifikimi i aplikantit si punonjës sigurie brenda afatit 3 mujor nga datat e aplikimit për ri-çertifikim, punonjësit të sigurisë i tërhiqet e drejta për të ushtruar detyrat e tij/saj si punonjës sigurie.
- h) Funksionet – punonjësi i sigurisë nuk mund të ushtroj detyra të tjera përveç atyre të përcaktuara në Çertifikatën e lëshuar nga AAC në përputhje me pozicionin e punës.

- i) Humbja e të Drejtës së Çertifikatës – punonjësi që humbet të drejtën për të ushtruar detyrat e tij në rastet kur ai i jep një personi tjetër çertifikatën e tij, ose gjendet duke ushtruar funksione të tjera nga ato që përcaktohen në çertifikatë si dhe në rastet e parashikuara në pikën 7, gërma (b), (c) dhe (d) të kësaj procedure.
- j) Shkelja apo mos respektimi i kësaj Procedure – dështimi në respektimin e kësaj procedure përbën shkelje administrative.

7. KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM PUNONJËS SIGURIE

Në mënyrë që një aplikant të çertifikohet si punonjës sigurie, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për çertifikim dhe dokumentat si më poshtë:

- a) mjet identifikimi që vërteton moshën mbi 18 vjeç;
- b) sjellë çertifikatën mjeksore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar dhe të firmosur nga komisioni prej tre mjekëve.
- c) sjellë çertifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet së bashku me tezën e testimit dhe syllabus;
- d) nota minimale kaluese të jetë 80%.
- e) sjellë dëshmi për kalimin me sukses të testimit praktik;
- f) sjellë dëshmi penaliteti;
- g) sjellë një fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- h) ketë kaluar me sukses kontrollin e pastërtisë së figurës.
- i) sjellë formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e haspirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit
- j) sjellë 2 fotografi

8. KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM – OPERATOR SKANERI

Në mënyrë që një aplikant të çertifikohet si Operator Skaneri, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për çertifikim dhe dokumentat si më poshtë:

- a) mjet identifikimi që vërteton moshën mbi 18 vjeç;
- b) sjellë çertifikatën mjeksore mjeku i fushës përkatëse të analizuar dhe të firmosur nga komisioni prej tre mjekëve;
- c) sjellë çertifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet së bashku me tezën e testimit dhe syllabus;
- d) nota minimale kaluese të jetë 80%.
- e) sjellë dëshmi për kalimin me sukses të testimit praktik;
- f) ketë kaluar me sukses testin kompjuterik (CBT) nën mbikqyrjen e Instrukturëve të SCMPSA të AAC-së.
- g) sjellë dëshmi penaliteti;
- h) sjellë një fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- i) testet çertifikuese duhet të bëhen ose nën mbikqyrjen e AAC-së, ose nga persona të autorizuar nga AAC.
- j) ketë kaluar me sukses kontrollin e pastërtisë së figurës.
- k) sjellë formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e haspirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 vite të fundit;
- l) sjellë 2 fotografi.

9. KËRKESAT PËR ÇERTIFIKIM – DREJTUES SIGURIE

Në mënyrë që një aplikant të çertifikohet si Drejtues Sigurie, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për çertifikim dhe dokumentat si më poshtë:

- a) mjet identifikimi që vërteton moshën mbi 18 vjeç;
- b) sjellë çertifikatën mjeksore mjeku i fushës përkatëse të analizuar dhe të firmosur nga komisioni prej tre mjekëve.
- c) sjellë çertifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet së bashku me tezën e testimit dhe syllabus;
- d) Intervistë me gojë pranë DSA në AAC.
- e) nota minimale kaluese të jetë 80%.
- f) sjellë dëshmi për kalimin me sukses të testimit praktik;
- g) sjellë dëshmi penaliteti;
- h) sjellë një fotokopje të dokumentit të identifikimit;

- i) testet çertifikuese duhet të bëhen ose nën mbikqyrjen e AAC-së, ose nga persona të autorizuar nga AAC.
- j) ketë kaluar me sukses kontrollin e pastërtisë së figurës.
- k) sjellë formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e haspirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 vite të fundit
- l) sjellë 2 fotografi.

10. KËRKESAT PËR RI-ÇERTIFIKIM

Në mënyrë që një aplikant të ri-çertifikohet si punonjës sigurie operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për riçertifikim dhe dokumentat si më poshtë:

- a) sjellë dëshmin e trajnimit ri-freskues për pozicionin që mban;
- b) sjellë dëshmin e trajnimit periodik teorik dhe atij kompjuterik;
- c) rezultatet e trajnimeve periodike dhe kompjuterike;
- d) sjellë vlerësimet e bëra nga supervizorët apo menaxherët;
- e) rezultatet e testeve/drilleve të bëra gjatë kreyrjes së detyrave;
- f) sjellë të gjitha vërejtjet apo promovimet të bëra nga eprorët;
- g) sjellë dëshminë e penalitetit.

11. TRAJNIMI

Trajnimi i personelit të sigurisë në fushën e sigurisë së aviacionit civil duhet të bëhet sipas Urdhërit të Përbashkët Nr. 4103, datë 19.09.2011 për “Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil”, Kapitulli 2, pika 2.7.

13. VLERËSIMI

Drejtoria e Sigurisë është përgjegjëse për vlerësimin e dosjeve të personelit të sigurisë. Nëse punonjësit e Sektorit të Çertifikimit dhe Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë në Aviacion, konstatojnë se dosjet e sjella për çertifikim janë të plota me

dokumentacionin e kërkuar në këtë procedurë, plotësohet çertifikata nga Inspektori i SCMPSA, firmoset nga Drejtori i DSA dhe Drejtori Ekektiv.Format e çertifikatave gjenden në Shtojcën A të kësaj procedure.

Nëse punonjësit e Sektorit të Çertifikimit dhe Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë në Aviacion, konstatojnë se dosjet e sjella për riçertifikim janë të plota me dokumentacionin e kërkuar në këtë procedurë, përditesohet çertifikata nga Inspektori i SCMPSA me afatet e reja, firmoset nga Drejtori i DSA.



Nëse punonjësit e Sektorit të Çertifikimit dhe Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë në Aviacion, konstatojnë se dosjet e sjella për çertifikim dhe riçertifikim, nuk janë në përputhje me këtë procedurë, kanë të drejtë t'i refuzojnë çertifikimin apo riçertifikimin ç'do aplikanti.

Punonjësi humbet të drejtën për të ushtruar detyrat e tij në rastet kur ai i jep një personi tjetër çertifikatën e tij, ose gjendet duke ushtruar funksione të tjera nga ato që përcaktohen në çertifikatë si dhe në rastet e parashikuara në pikën 7, gërma (b), (c) dhe (d) të kësaj procedure.

Dështimi për të ndërmarr dhe për të plotësuar me sukses riçertifikimin me një afat që nuk kalon 3-muaj, duhet të shoqërohet me tërheqjen e çertifikimit.

Hapi Nr.	Subjekti kërkues	Protokoll i AAC	Drejtori DSA	Inspektori i SCMPA	Përshkrimet
1.					Paraqitja e kërkesës për Çertifikim ose Riçertifikim në rrugë zyrtare pranë AAC
2.					Kalimi i praktikës për trajtim nga Drejtori i DSA tek Inspektori i SCMPA
3.					Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, konform PKTSAC Nëse ka mungesë në dokumentat e paraqitura, i dërgohet e: mail subjektit të interesuar për plotësim dokumentacioni.
4.					Plotësimi i Çertifikatave, kalimi për firmë te Drejtori i DSA. Prgatitja e Memos për DE
5.					Prgatitja e shkresës përcjellëse. Dërgimi i Çertifikave për firmë pranë DE.
6.					Vulosja e Çertifikatave në Protokoll. Arshivimi

SHTOJCA A

	<p data-bbox="1050 667 1107 748"></p> <p data-bbox="959 786 1230 835">REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA</p> <p data-bbox="908 880 1262 929">AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY</p> <p data-bbox="884 949 1272 1079"></p> <p data-bbox="893 1158 1299 1207">DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION DIRECTORY OF AVIATION SECURITY</p> <p data-bbox="967 1234 1158 1263"><u>CERTIFIKATË</u></p> <p data-bbox="885 1301 1303 1364">PERSONEL I SIGURISË SË SHOQËRIVE AJRORE</p> <p data-bbox="967 1413 1158 1442"><u>CERTIFICATE</u></p> <p data-bbox="900 1469 1249 1498">AIRLINE SECURITY STAFF</p> <p data-bbox="836 1543 1378 1632">Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSH, PKTSAC, Aneksin 17 të ICAO-s dhe DOK.30 të ECAC. Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKTSAC, ICAO Annex 17 and ECAC Doc.30</p>
--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTIFIKATË
PERSONEL I SIGURISË SË SHOQËRIVE AJRORE

CERTIFICATE
AIRLINE SECURITY STAFF

Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSH, PKTSAC, Aneksin 17 të ICAO-s dhe
DOK.30 të ECAC.

Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKTSAC, ICAO Annex 17 and
ECAC Doc.30

SHTETI LËSHUES SHQIPËRIA STATE OF ISSUE ALBANIA		AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY		
Nr i Certifikatës: Certificate No :		foto	DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION DIRECTORY OF AVIATION SECURITY	
Emër/Mbiemër: Name/Surname:			<u>KATEGORIA</u> CATEGORY	
Data dhe Vendi i Lindjes : Date and Place of Birth :			<u>POZICIONI</u> POSITION	
Adresa e Plotë: Full Address :				
Shtetësia: Citizenship:				
Nënshkrimi i mbajtësit : Signature of Holder:		Posti i Mbajtësit dhe çdo ndryshim: Holder position and other changes:	Vlefshmëria / Validity	
			Nga From	Deri Till
				Firmë/Sign DSA
Data e lëshimit: Date of Issue :	Data e Skadimit: Date of Expiry :			
Autorizuar/ nënshkruar nga: Authorised/ signed by:		Vula: Stamp:		

Kushtet dhe Afatet /Terms and Conditions:

Certifikata duhet të ketë fotografinë e mbajtësit dhe hollësitë e tjera.
Certificate should bear the holder's photograph and other details.

Mbajtësi i kësaj Certificate është i vetmi person që mund të kryejë detyrat e sigurisë së aviacionit sipas postit të shënuar në këtë dokument.

The Holder of this Certificate is the only person who is allowed to conduct security duties according to the definition of the post held as specified in this document.

Pas pajisjes me këtë Certificate, mbajtësi detyrohet të zbatojë në çdo moment dispozitat, rregulloret, praktikat dhe procedurat siç përmbahen në kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit civil dhe detyrimet ndërkombëtare në përputhje me ICAO Aneksin 17 – Siguria, legjislacionin për Aviacionit Civil Shqiptar, dhe ECAC Doc 30 – Pjesa II Siguria (I kufizuar).

*Immediately after being granted this Certificate, the Holder **MUST**, at all times, abide with and enforce all the provisions, regulations, practices and procedures as contained at national civil aviation security requirements and international obligations in compliance with ICAO Annex 17 - Security), national legislation of civil aviation and ECAC Doc. 30, Part II –Security (Restricted).*

Ky dokument është në pronësi të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar dhe në momentin që mbajtësi nuk është më tej agjent sigurie ose certifikata konsiderohet e pavlefshme, duhet të rikthehet menjëherë në zotërim të AAC.

This document is property of the Albanian Civil Aviation Authority and at the moment the holder is no longer a security agent, or the certificate is considered as invalid, it should be returned immediately to the ACAA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTIFIKATË

PERSONEL I SIGURISË SË ATM

CERTIFICATE

ATM SECURITY STAFF

Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSH, PKTSAC, Aneksin 17
të ICAO-s dhe DOK.30 të ECAC.
Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKTSAC, ICAO
Annex 17 and ECAC Doc.30



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTIFIKATË
PERSONEL I SIGURISË SË ATM

CERTIFICATE
ATM SECURITY STAFF

Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSH, PKTSAC, Aneksin 17 të ICAO-s dhe
DOK.30 të ECAC.

Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKTSAC, ICAO Annex 17 and
ECAC Doc.30

SHTETI LËSHUES SHQIPËRIA STATE OF ISSUE ALBANIA		AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY		
Nr i Certifikatës: Certificate No :	foto	DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION DIRECTORY OF AVIATION SECURITY		
Emër/Mbiemër: Name/Surname:		<u>KATEGORIA</u> CATEGORY		
Data dhe Vendi i Lindjes : Date and Place of Birth :		<u>POZICIONI</u> POSITION		
Adresa e Plotë: Full Address :				
Shtetësia: Citizenship:				
Nënshkrimi i mbajtësit : Signature of Holder:		Posti i Mbajtësit dhe çdo ndryshim: Holder position and other changes:	Vlefshmëria / Validity Nga From	Deri Till
Data e lëshimit: Date of Issue :	Data e Skadimit: Date of Expiry :			Firmë/Sign DSA
Autorizuar/ nënshkruar nga: Authorised/ signed by:	Vula: Stamp:			

Kushtet dhe Afatet /Terms and Conditions:

***Certifikata duhet të ketë fotografinë e mbajtësit dhe hollësitë e tjera.
Certificate should bear the holder's photograph and other details.***

Mbajtësi i kësaj Certificate është i vetmi person që mund të kryejë detyrat e sigurisë së aviacionit sipas postit të shënuar në këtë dokument.

The Holder of this Certificate is the only person who is allowed to conduct security duties according to the definition of the post held as specified in this document.

Pas pajisjes me këtë Certificatë, mbajtësi detyrohet të zbatojë në çdo moment dispozitat, rregulloret, praktikat dhe procedurat siç përmbahen në kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit civil dhe detyrimet ndërkombëtare në përputhje me ICAO Aneksin 17 – Siguria, legjislacionin për Aviacionin Civil Shqiptar, dhe ECAC Doc 30 – Pjesa II Siguria (I kufizuar).

Immediately after being granted this Certificate, the Holder MUST, at all times, abide with and enforce all the provisions, regulations, practices and procedures as contained at national civil aviation security requirements and international obligations in compliance with ICAO Annex 17 - Security), national legislation of civil aviation and ECAC Doc. 30, Part II –Security (Restricted).

Ky dokument është në pronësi të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar dhe në momentin që mbajtësi nuk është më tejet agjent sigurie ose certifikata konsiderohet e pavlefshme, duhet të rikthehet menjëherë në zotërim të AAC.

This document is property of the Albanian Civil Aviation Authority and at the moment the holder is no longer a security agent, or the certificate is considered as invalid, it should be returned immediately to the ACAA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTIFIKATË

PERSONELI I SIGURISË SË AEROPORTIT

CERTIFICATE

AIRPORT SECURITY STAFF

Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSF, PKISAC, Aneksin 17
të ICAO-s dhe DOK.30 të ECAC.
Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKISAC, ICAO
Annex 17 and ECAC Doc.30



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTIFIKATË
PERSONELI I SIGURISË SË AEROPORTIT

CERTIFICATE
AIRPORT SECURITY STAFF

Lëshuar në përputhje me Kodin Ajror të RSH, PKTSAC, Aneksin 17 të ICAO-s dhe
DOK.30 të ECAC.

Issued in compliance with the Albanian Air Code, PKTSAC, ICAO Annex 17 and
ECAC Doc.30

SHTETI LËSHUES SHQIPËRIA STATE OF ISSUE ALBANIA		AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL CIVIL AVIATION AUTHORITY			
Nr i Certifikatës: Certificate No :	foto	DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION DIRECTORY OF AVIATION SECURITY			
Emër/Mbiemër: Name/Surname:		<u>KATEGORIA</u> <u>CATEGORY</u>			
Data dhe Vendi i Lindjes : Date and Place of Birth :		----- <u>POZICIONI</u> <u>POSITION</u> -----			
Adresa e Plotë: Full Address :					
Shtetësia: Citizenship:					
Nënshkrimi i mbajtësit : Signature of Holder:	Posti i Mbjtësit dhe çdo ndryshim: Holder postion and other changes:	Vlefshmëria / Validity		Firmë/Sign	
		Nga From	Deri Till	DSA	
Data e lëshimit: Date of Issue :	Data e Skadimit: Date of Expiry :				
Autorizuar/ nënshkruar nga: Authorised/ signed by:	Vula: Stamp:				

Kushtet dhe Afatet /Terms and Conditions:

Certifikata duhet të ketë fotografinë e mbajtësit dhe hollësitë e tjera.
Certificate should bear the holder's photograph and other details.

Mbajtësi i kësaj Certificate është i vetmi person që mund të kryejë detyrat e sigurisë së aviacionit sipas postit të shënuar në këtë dokument.

The Holder of this Certificate is the only person who is allowed to conduct security duties according to the definition of the post held as specified in this document.

Pas pajisjes me këtë Certificatë, mbajtësi detyrohet të zbatojë në çdo moment dispozitat, rregulloret, praktikat dhe procedurat siç përmbahen në kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit civil dhe detyrimet ndërkombëtare në përputhje me ICAO Aneksin 17 – Siguria, legjislacionin për Aviacionin Civil Shqiptar, dhe ECAC Doc 30 – Pjesa II Siguria (I kufizuar).

*Immediately after being granted this Certificate, the Holder **MUST**, at all times, abide with and enforce all the provisions, regulations, practices and procedures as contained at national civil aviation security requirements and international obligations in compliance with ICAO Annex 17 - Security, national legislation of civil aviation and ECAC Doc. 30, Part II –Security (Restricted).*

Ky dokument është në pronësi të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar dhe në momentin që mbajtësi nuk është më tejet agjent sigurie ose certifikata konsiderohet e pavlefshme, duhet të rikthehet menjëherë në zotërim të AAC.

This document is property of the Albanian Civil Aviation Authority and at the moment the holder is no longer a security agent, or the certificate is considered as invalid, it should be returned immediately to the ACAA.